

## PUBLIKE

## DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

Hagë

Holandë

Numri: KSC-BC-2019-2

Vendos: Paneli i gjykatësit të vetëm

Gjykatës: Nikola Giju

Datë: 10 mars 2019

Gjuha: Shqipe

Klasifikimi: Publik.

---

**KUNDËRPËRGJIGJE NDAJ PËRGJIGJES TË ADMINISTRATORES**

---

**Parashtuesi:** Dr. Sc. Hazër R. Susuri, avokati mbrojtës  
i parashtuesit zotëri Ruzhdi Saramati

Duke u ndërlidhur në Urdhrin e Gjyqtarit individual Nikola Giju, gjykatës i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, Holandë, avokati mbrojtës dr.sc. Hazër R. Susuri me Avokaturë në Prizren, i parashtuesit zotëri Ruzhdi Saramati nga fshati Dobrushtë, komunë e Prizrenit, Republikë e Kosovës, në afatin e caktuar nga Urdhëresa e Gjyqtarit individual, e parashton Kundërpërgjigjen ndaj përgjigjes të Administratores Dr. Fidelma Donlon datë 6 mars 2019, në Kërkesën për rishikimin e vendimit Ref: KSC/REG/IOR 1632 datë 18.02.2019, lidhur me refuzimin e ndihmës juridike falas për parashtuesin z. Ruzhdi Saramati, duke theksuar si në vijim:

**I/ HISTORIKU PROCEDURAL**

Theksoi se Përgjigja e parashtruar nga Administratorja Dr. Fidelma Donlon, datë 6 mars 2019, sipas Urdhrit të gjyqtarit individual Nikola Giju datë 4 mars 2019, fare nuk na është dorëzuar e përkthyer në gjuhën shqipe, por vetëm në gjuhën angleze (për shkak të afatit të kundërpërgjigjes). Megjithatë po e zbatojmë detyrimin e urdhëruar nga Gjykatësi individual i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, Holandë, në këtë çështje të vendosjes.



Historikut procedural konsideroi se është i njëjti të cilin e ka përcaktuar Administratorja Dr. Fidelma Donlon (në vijim: Administratorja) në parashtrimin e kërkesë për ndihmë juridike falas nga parashtruesi z. Ruzhdi Saramati me tërë dokumentacionin e bashkëngjitur (19) shtojcat për këtë deri në refuzimin e ndihmës juridike falas nga Administratorja si dhe historiku i përfshirë nga gjykatësi individual Nikola Giju deri më tani.

Në këtë z. Ruzhdi Saramati e ka parashtrua Kërkesën për Rishikimin e Vendimit të Administratores më datë 23 shkurt 2019, duke konsideruar se Vendimi i saj është kundërligjor me propozim që ndihma juridike falas për z. Ruzhdi Saramatin është ligjërish e bazuar dhe se të njëjtit duhet lejuar ndihmën juridike falas.

### III/ ÇËSHTJA E KUNDËRPËRGJIGJES

Avokati mbrojtës Dr. Sc. Hazër R. Susuri, i parashtruesit z. Ruzhdi Saramati, konsideron se përgjigja e Administratores dr. Fidelma Donlon e datës 6 mars 2019, është ligjërish e pa bazuar dhe si i tillë duhet të hedhet në procedurën e rishikimit për arsyet vijuese:

1. Me vendimin Ref: KSC/REG/IOR/1632 datë 18.02.2019 për refuzimin e ndihmës juridike falas dhe për caktimin e avokatit mbrojtës, Administratorja gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në këtë ka marr vendim jo ligjor, kështu që arsyetimet nga Përgjigja e Administratores nuk mund të qëndrojnë në bazën e refuzimit për ndihmën juridike falas për z. Ruzhdi Saramatin.

2. Nuk qëndron gjendja faktike se Z. Ruzhdi Saramati nuk i paska plotësuar kushtet ligjore dhe ato nga Rregulloret përkatëse për fitimin e të drejtës për ndihmë juridike falas dhe caktimin e avokati mbrojtës, por z. Saramati. në bazë të dokumentacionit të parashtruar e të bashkëngjitur për Gjykatësin individual për të vendosur në shkallë të dytë, vërtetohet se z. Ruzhdi Saramati i plotëson kushtet ligjore për ndihmë juridike falas.

3. Parashtruesi Z. Ruzhdi Saramati i ka dhënë në formën e shkruar (përmes emailit) të gjitha informacionet të besueshme dhe të vërtetuara lidhur me 3 (tri) llogaritë të cilat i ka të vetmet në qarkullimin bankar dhe të njëjtat janë të vërteta dhe plotësisht të përputhshme me Raportin e qarkullimit banka për secilën llogari, pra ashtu siç ka konstatuar edhe Gjykatësi Individual Nikola Giju, gjykatës i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, Holandë duke precizuar se:

*"13. Numri i kartelës i njëjës prej llogarive të Parashtruesit në Raiffeisen Bank22 është i njëjtë me numrin e shënuar prej tij në Formularin e Dhënies së Pëlqimit.23 Ndonëse, siç tregohet më lart, deklarata bankare përkatëse nuk jep numrin e plotë të kartelës bankare,24 5167 66\*\* \*\*\*\* 6955, ky numër, më së paku ka ngjashmëri të konsiderueshme me numrin e shënuar në Formularin e Dhënies së Pëlqimit (5167 6694 2582 6955)"<sup>1</sup>.*

4. Llogaria tjetër bankare Z. Saramati nuk ka dhe se kjo gjendje është e vërtet për llogaritë bankare si dhe për provat tjera të bashkëngjitura e të cilat janë publike dhe mund të verifikohen tek organet kompetente në rast dyshimi.

<sup>1</sup> Urdhri për Administratoren lidhur me parashtrimin e përgjigjes KSC-BC-2019 datë 4 mars 2019 i gjyqtarit individual i Dhomave të Specializuara të Kosovës, Hagë, Holandë.



3. Informacionin për automjetin z. Saramati e ka deklaruar kur Administratorja e ka kërkuar atë dhe se ky informacion është i plotë dhe gjendet në shkresat e bashkëngjitura dhe është provë e vlefshme me të cilën mund të vendoset.

4. Administratorja provat e parashtruara nga z. Saramati i ka shikuar në vendimmarrje nga aspekti formal e jo faktiko juridik e material, ndaj dhe vendosja e tillë me Vendimin në rishikim nuk është ligjore dhe si i tillë vendimi i Administratores nuk e ka bazën ligjore të vendosjes për refuzim por e kundërta për aprovimin e ndihmës së kërkuar juridike falas për z. Ruzhdi Saramatin.

### III/ DISKUTIMI I ÇËSHTJES

Hypotetikiisht po e diskutoi Kërkesën për rishikimin e Vendimit Ref.: KSC/REG/IOR/1632 të Administratore Dr. Fidelima Donlon datë 18 shkurt 2019, po të vërtetohej Vendimi si i tillë me refuzimin e ndihmës juridike falas, *parashtruesi z. Ruzhdi Saramati do të ngelte pa avokat mbrojtës ngase seriozisht nuk ka kushte financiare për ta paguar* privatisht avokatin mbrojtës. Në këtë rast do të paraqitet problemi i sigurimit të avokatit mbrojtës për Z. Ruzhdi Saramatin në procedurën e mëtejme të tij penale e që Dhoma e Specializuar e Kosovës doemos është e detyruar ti caktoi avokat mbrojtës ngase pa atë do të bllokohej procedura penale kundër z. Ruzhdi Saramatin.

Prandaj edhe në këtë Kërkesa për rishqyrtim e z. Saramatin është ligjorisht e bazuar.

### IV/ KONFIDENCIALITETI

Duke qenë se Kundërpërgjigja është e karakterit publik e cila parashtrohet nga Avokati mbrojtës i Z. Ruzhdi Saramati, konsideroj se e mban klauzolën e dokumentit PUBLIK.

### VI/ PROPOZIMI

Propozoi që Përgjigja e administratores Dr. Fidelma Donlon datë 6 mars 2019, në Kërkesën për rishikimin e vendimit Ref: KSC/REG/IOR 1632 datë 18.02.2019 të parashtruesit z. Ruzhdi Saramati lidhur me refuzimin e ndihmës juridike falas, TË REFUZOHET

Kundërpërgjigja e avokati mbrojtës dr. sc.(Phd) Hazër R. Susuri, i z. Ruzhdi Saramati, të aprohet si ligjorisht e bazuar me aprovimin e kërkesës për ndihmën juridike falas për z. Ruzhdi Saramati.

Prizren,  
L11.03.2019.

**AVOKAT**  
Hazër SUSURI  
hazersusuri@hotmail.com  
+377(0)44/131-117 tel: 029/631-909  
I.Lutfiu 12, 20000 Prizren

Për z. Ruzhdi Saramati  
Avokati mbrojtës Dr.sc. Hazër R. Susuri